Kërkimi i një pune

Kërkimi i punës mund të bëhet vetvetiu. Megjithatë, komunikimi dhe kodet kulturale të vendit luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Pra është e domosdoshme të interesoheni mirë përpara se të veproni: nuk mjafton të keni cilësi të mira, duhet të mundoheni ti vëni në dukje dhe të shpreheni në formën e pritur nga punëdhënësi. Egzistojnë, për këtë, shërbime të specializuara që munden të më orientojnë.

Pyetjet që janë për tu bërë:

	PO	JO	
A mund ti bëj dokumentat e nevojshme ?			Plotësoj dosjen time : barasvlefshmërinë e diplomës, patentën çertifikatën e formacionit vërtetimet, regjistrimin si kërkues pune...
A mund të shprehem qartë për projektin tim profesional dhe kompetencat e mia ?			Realizoj një bilanc të kompetencave, për shembull në Forem, në një organizëm për integrimin social-profesional në një Qëndër Krahinore për Integrimin....
A kam një CV të mirë dhe një letër të mirë të motivimit? cilat janë cilësitë e mia, njohuritë e mija, komptencat e mia? Ai përgjigjen ato nevojave të punëdhënësit?			
A mund të kërkoj vetëm? A kam informacione të mjaftueshme, për shembull për të vendosur nëse dërgoj kandidatura me iniciativën time ose nëse i përgjigjem ofertave të punës?			Marr këshillë pranë FOREM-it , një shtëpi lagjeje, një organizëm për integrimin-social-professionel… ose marr pjesë në një atelier për kërkim pune.
A kam në një takim për punë çfare do të them? Si do të presentohem?			Marr këshillë pranë një organizimi që propozon punecoaching ose ushtrohem në një atelier për kërkim pune.

www.discri.be
Cap Migrants - capmigrants@skynet.be

Kërkimi i një pune

FOREM është një shërbim publik për punën dhe formacionin (kursin) profesional në Wallonie. Në Forem unë regjistrohem si kërkues pune. Në faqen (në internet) e tij www.leforem.be, unë mund të përdor një seri shërbimesh në linjë: oferta pune, formacione, informacion mbi zanatet, sallona të punës. Kur unë jam kërkues pune, këshilltarët ndjeknin dosjen time dhe munden të më orientojnë.

Duke qënë kërkues i (e) punës, duhet të plotësoj një seri detyrimesh sidomos ato të kërkimit me këmbëmgulje të punës. Në qoftëse une marr një ftëse, jam i detyruar të shkoj. Kujdesem që të ruaj të gjitha provat e kërkimeve (për punë) dhe informoj këshilltarin (en) tim(e) për çdo ndryshim në situatën time.

Një tjetër zgjidhje është e deklaruar shumë e frytshme për të gjetur një punë : rrjeti i lidhjeve që bëj rreth meje. Mendohet që një pjesë e madhe e vendeve të punës : gjenden nëpërmjet të tjerëve : rrethi shoqëror, miqitë, familja janë shpesh aleatë të çmuar. Shumë punëdhënës kanë prirje të bëjnë besim një rekomandimi personal.

Midis strategjive të integrimit, gërshetimi i lidhjeve të besimit është pra për tu vëne midis përparësive.

Agjensitë e punëdhënies të përkohshme janë gjithashtu një bashkëbisedues i privilegjuar për disa sektore të veprimtarish (activite). Në belgjik, shumë ndëmarrje janë të prezantuara në Wallonie. Zëvendësi i përkohshëm është i angazhuar nga një agjenci e punëdhënies (që jep punë përkohësisht) për llogarinë e një purëdhënësi që ka nevojë për një punë përkohësisht. Kjo lloj punë siç e kërkon rregullorja dhe zëvendësi i përkohshëm përfiton të njëjtat të drejta si punëtorët e tjerë në çështje me pensionet, pushimet, sigurimet e sëmundjes…

Disa agjensi janë të ndjeshme pyetjeve që lidhen me ndryshimet e kulturave.

Lajmerimet e vogla të publikuara në gazetë, në kutijat (e letrave) dhe në internet janë edhe ato një menyrë klasike për të gjetur punë.

Unë jam megjithatë i(e) vemendshëm (me) të lexoj mirë lajmërimet, të zbuloj punën në të zezë ose mashtrimet. Shmangem për shembull të shkoj në një takim në hotel… Nga kjo pikëpamje, është e preferueshme të konsultoni shtypin e specializuar dhe publikimin e FOREM-it.

Kur e kam përcaktuar profilin tim, projektin tim professional dhe kompetencat e mia, une mundem ti dërgoj punëdhënësit një kandidature me iniciativën time .Për aq sa kërkimi dhe komunikimi të jenë në shenjë të mirë, kjo strategji është konsideruar si një nga më të frytshmet.

Më në fund, shumë organisme të integrimit socail-profesional (OISP), shoqata të ndryshme, shtëpija të lagjes, administrat e lagjes proposojne shërbime shoqëruese për zhvillimin një strategjie të mirë për kërkimin e punës. Në qoftëse nuk i përdor aparatet e ndërlikuara të ushtrimit, nuk hezitoj t'ju bëj thirrje kompetencave të tyre.

Njëvlërsimi i diplomave

Për shumicën e diplomave të huaje, njëvlerësim duhet kërkuar pranë shërbimit të Njëvlerësimit të Komunitetit Françez.

Kujdes, procedura për njohjen e diplomës është e gjatë dhe kërkon përbërjen e një dosje të hollësishme që i përgjigjet kërkesave te sakta.

Lidhje e nevojshme : www.equivalences.cfwb.be 02 690 86 86

CENTRE POUR L'ÉGALITÉ DES CHANCES ET LA LUTTE CONTRE LE RACISME

Diskriminimi në takimet për punë është e ndaluar dhe e dënueshme nga ligji. Megjithatë ajo nuk mjafton ti heqë steriotipat dhe paragjykimet që karakterizojnë disa mentalitete. Pra duhet të keni kujdes dhe të përgatiteni të përballoheni me situata të tilla. Kur një diskreminim është i provuar, ai mund të denuncohet. qendra për barazinë e shanseve dhe lufta kundër Racizmit është një shërbim publik i pavarur që ka për mision të ligjshëm nxitjen e barazisë dhe luftën kundër diskriminimit.. Ai mund të veprojë në emër të personit të diskriminuar. Në rast problemi, unë mund të marr këshillë pranë këtyre shërbimeve: linja jeshile falas në 0800/12800 ose www.diversite.be

Kontrata e punës

Në Belgjik, puna është siç e kërkon rregullorja në një mënyrë të ndryshme sipas sektoreve. Flasim në përgjithësi për sektorin privat, sektorin publik, sektorin tregtisë, sektorin (që nuk ka për qëllim fitimin). Në veçanti, çdo sektor (për shembull sektori i ndërtimit) është rregulluar nga një <<komision që përcakton kushtet e punës.

Puna nënkupton që atëherë një kontratë pune. Është një angazhim i ligjshëm që lidh dy palët të paktën dhe që krijon të drejta edhe detyrime. Palët janë zakonisht të quajtura << punëdhënësi >> dhe << punëtori >> (ose << nëpunësi>>).

Kontrata e punës kur bëhet, për të dyja palët ka detyrime (orari, puna, rroga, pushimet,...). punëdhënësi dhe punëtori duhet të kënë respekt dhe përfillje të dyanshme. Ato duhet të sigurojnë dhe të vëzhgojnë respektin e mirësjelljes dhe veprimet e mira gjatë zbatimit të kontratës.

Egzistojnë disa lloje kontratash: të plotë, kontratë të pjesshme, zevëndësimi, (punëdhënësi është agjencia që jep punë përkohësisht) me zgjatje të përcaktuar, (CDD = datat e fillimit dhe e mbarimit janë të shënuara në kontratë), me zgjatje të papërcaktuar (CDI = zgjatje e kontratës nuk është e përcaktuar)...

Në të shumtën e kohës, kontrata parashikon një periudhë prove: kjo periudhë lejon të dyja palëve për të verifikuar nëse ato përshtaten dhe, nëse nuk është rasti, të ndërprejnë kontratën shpejt dhe pa dëmshpërblim.

Kur punëdhënësi ose punëtori dëshiron ti japë fund kontratës një periudhë palalajmërimi është parashikuar nga rregullorja një afat minimum respektohet para se ta lini punën. Ky afat që duhet respektuar varet sipas situatës dhe tipit të kontratës.

Pra gjithmonë, unë sigurohem të nënshkruaj një kontratë në formë të mirë dhe të rregullt. për një përvojë të parë ose në rast dyshimi ; marr këshillë pranë një sindikate që mbron intersant e punëtorëve, pranë FOREM-it ose pranë një shërbimi social.

Leja e punës

Puna e punëtorëve të huaj është përveç kësaj e rregulluar nga ligji i 30 prilit 1999 nga vendimi mbretëor i 9 qershorit 1999 (persa i përket atyre me rroge) rregullat në çështje me hyrjen në tregun e punës të punëtorëve të huaj, si dhe rregullat në çështje me marrjen e një titulli të qëndrimit janë të ndërlikuara.

Egzistojnë tre kategori të lejes së punës

Leja A: me zgjatje të pakufizur , e vlefshme për të gjitha profesionet me rrogë dhe për të gjithë punëdhënësit. punëdhënësi që angazhon një person me leje A nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti. E dërgoj unë vetë kërkesën në FOREM.

Leja B: me zgjatje të kufizuar për 12 muaj, e kufizuar për punë pranë një punëdhënësi të vetëm, e kufizuar vetëm në një krahinë (Wallone, të Brukselit, ose flamane) . Nuk jepet vetëm në qoftëse nuk është e mundur të gjejë një punëtor të aftë mes punëtorëve që janë të pranishëm në tregun e punës. Punëdhënësi bën një kërkëse për lejen në Shërbimin Publik Wallon.

Leja C: me zgjatje të kufizuar për një vit maksimum, me përsëritje, e vlershme për të gjitha profesionet me rrogë dhe për gjithë punëdhënësit, për të gjitha krahinat e vendit. Ai i përket disa katergorive të huajsh për arsyje të titullit të qëndrimit tyre. Ai humb vlefshmërinë kur titullari humb të drejtën e tij të qëndrimit, përveç gjatë periudhës të shqyrtimit të një ankese kundër urdhërit për lëshuar Territorin e bërë pranë CCE. E dërgoj unë vetë kërkesën time në Zyrën krahë-pune të huaj në FOREM.

Adresa që ju nevojiten

SPW - D6 operativ i Ekonomisë, të Punës të Kërkuar

Departamenti i Punës dhe i Kursit Profesional

Drejtorie e punës dhe leja e punës

Place de Wallonie, 1 – bâtiment 2

5100 Jambes

Leja e punës

Refugjati i njohur (CIRE e pakufizuar) nuk ka nevojë për leje pune.

Për fituesi i mbrojtjes dytësore (CIRE e kufizuar për një vit, që përsëritet, dhe që mund të bëhet përfundimtare mbas 5 vjetësh) mund të punojë me **lejen C**. Në qoftëse qëndrimi i tij bëhet i pakufizuar, ai **s'ka nevojë** për leje pune.

Kërkuesi i azilit mund të punojë me **leje C** vetëm, 6 muaj mbasi ka bërë kërkesën e tij të azilit, ai nuk ka marrë akoma përgjigjje nga CGRA.

I huaji që ka bërë një kërkesë për rregullim për arsyje humanitare (9bis) dhe që është deklaruar i pranueshëm mund të marrë një CIRE të kufizuar për një vit, që përsëritet me disa kushte ose një qëndrim përfundimtar. Në qoftëse ai merr një qëndrim të kufizuar, ai mund të punojë me **lejën C**, **vetëm nëse përsëritje qëndrimit është nënshtruar kushtit për hyrjen në punë**. Në qoftëse qëndrimi është i pakufizuar, ai nuk nevojë për leje pune. Kujdes, deri sa kërkesa e tij nuk ka marrë përgjigjje, ai është me qëndrim të ligjshëm dhe nuk ka pra të drejtën të punojë.

I huaji që ka bërë një kërkesë për rregulim për arsyje mjekësore (9 ter) nuk mundet të punojë deri sa ai është në periudhën e pranueshmërisë (vërtetimi i rregjistrimit = karta portokalle). Nëse ai merr një qëndrim të kufizuar, ai mund të punojë me **leje C.** Nëse ai merr një qëndrm të pakufizuar, ai **nuk ka nevojë** për leje pune.

Një pjesëtar i familjes të një shtetasi të një vendi të tretë që ka një qëndrim të pakufizuar (art.10) mund të marrë një vërtetim regjistrimi (karte portokalle), gjatë shqyrtimit të dosjes së tij, pastaj një qëndrim të kufizuar, që përsëritet që mund të bëhet i pakufizuar mbas 3 vitesh :

Me një vërtetim regjistrimi ose një qëndrim i kufizuar ai mund të punojë me një leje C. Me qëndrim të pakufizuar, ai nuk ka nevojë për lejë pune. Pjesëtari i familjes të shtetasi të një vendi të tretë që ka një qëndrim të kufizuar (art.10 bis) merr një qëndrim të kufizuar për një vit ose që nuk e kalon vlefshmërinë e titullit të qendrimit të huajit që është bashkuar me të. Ai mund të punojë me **leje C**.

Leja e punës

I huaji që ka një qëndrim të ligjshëm dhe kërkon një ndryshim të statusit (për shembull një student që martohet) merr një vërtetim të regjistrimit për 6 muaj me zgjatje 2 herë 3 muaj. Nëse e drejta e qëndrimit është njohur, ai merr një CIRE të kufizuar për një vit, që përsëritet. Mbas 3 vitesh, qëndrimi bëhet i përhershëm. Me vërtetimin e regjistrimit ose duke qenë me qëndrim të kufizuar, i huaji mund të punojë me leje C. Me qëndrim të pakufizuar, ai nuk ka nevojë për leje pune.

Shtetasi i një vendi të tretë pjesëtar i familjes të një qytetari të Bashkimit Evropian ose të Harpësirës Ekonomike Evropiane (art.40 bis) **nuk ka nevoje** pë leje pune. Pasardhësi që ka në shumë se 21 vjeç ose parardhësi duhet ndërkohë të janë në ngarkim të qytetarit të B.E per të marrë këtë përjashtim.

I huaj i shtetasi një vendi të tretë me një viza me qëndrim të shkurtër ose që nuk ka nevojë për viza nuk ka asnjë të drejtë për të punuar.

Puna e pavarur

Për të ushtruar një veprimtari të pavarur (të jesh vetë padron), të gjithë personat që nuk kanë nënshtetësinë belge duhet të marrin një **kartë profesionale** pranë Shërbimit Publik Federal-Ekonomik-Klase mesatare-PME-Energji.

Disa kategori të huajsh janë megjithatë të përjashtuar:

- shtetasit e 25 vendeve të Bashkimit Evropian dhe disa pjësëtare të familjes së tyre që bashkohen me ta;
- refugjatët e njohur dhe titullarët me një qëndrim të pakufizuar;
- shtetasit e vendeve me të cilët Belgjika ka nënshkruar konventa;
- bashkëshortja e një Belgu dhe disa pjësëtare të familjes që bashkohen me ta;
- bashkëshortët që ndihmojnë burrin ose gruan në veprimtarië e pavarur (privat);
- personat që udhëtojnë për biznes, konferencierat, gazetarët, spartivat, artistat nëse zgjatja e qëndrimit nuk i kalon tre muaj rrjesht;
- studentat e huaj që bëjnë praktikën në kuadrin e studimeve të tyre.
- ...

Tjera kushte duhet të plotësohen: disa profesione që janë sipas rregullores.

Për një veprimtari që ka nevojë për një regjistrim në regjistrin e tregtisë ose të zejtarisë, duhet të provoni **njohuritë e qeverisjes** (të zanatit). Nëse është e nevojshme, une mund të kaloj një provim pranë Ministrisë të Klasve Mesatare.

Disa profesione kërkojnë provën e **njohuritë profesionale** dhe/ose të diplomave.

Për shumicën e diplomave të huaja, një barasvlefshmëri duhet të njihet dhe të kërkohet pra, pranë Shërbimit të Barasvlefshmërisë të Komunitetit Francez.

Puna e pavarur

Detyrimet administrative duhet të plotësohen , kryesisht :

- Pjesëmarrësi i një arke të sigurimeve shoqërore (të hollat që paguhen për çdo trimestër).
- Kërkoni një numër të ndërmarrjes në sportelin e ndërmarrjes zyrtare
- kërkoni një regjistrim në regjistin e tregtisë, 'me përjashtim të disa profesioneve ; profesione liberale, bujqësore).
- Deklarimin e veprimtarisë në TVA (plotësoni një deklaratë dhe paguani shumat që iu detyroheni çdo trimester (me përjashtim të disa veprimtarive: aktor, këngëtar, modele, disk-jackeys, profesione liberale) .
- Te hapin një numër llogarie të veçantë për vërprimtarinë e pavarur (private).
- Të mbani një llogaritje në formën e duhur dhe të mirë. është e këshilluar të rrethoheni nga shërbimet e një llogaritari.
- Të jeni pjesëtar i një mutueli. (institucioni që rimburson shpenzimet mjekësore, etj ..)
- Të paguani taksat (tatimet), sipas një deklarate vjetore

Faqe e nevojshme :
http://economie.fgov.be/fr/entreprises/vie_entreprise/Creer/Conditions

Puna në të zezë (e pa deklaruar)

Puna që nuk është e deklaruar është quajtur puna ne të zezë. Është nje veprimtari me rrogë, por e pa deklaruar pushtetit publik. Ajo i shpëton kështu të gjithave rregullave të solidaritetit të drejtësisë belge, (taksat, të hollat për sigurimet shoqërore) dhe është pra e dënuar nga ligji.

Shembull: Komshija ime më propozon të shkoj të lyej në shtëpinë e saj dhe më paguan 5 euro/në orë.

Gjatë punës në të zezë, nuk ka kontrate të punës së ligjshme. punëdhënësi gjasmë nuk i plotëson detyrimet e tija në çështje me sigurimet shoqërore dhe sistemit të tatimeve. Rreziqe të mëdhaja peshojnë për ketë lloj pune dhe mund të kenë pasoja të rënda për punëdhënësin edhe për punëtorin.

- Pa kontratë pune, rrezikoj të mos paguhen plotësisht ose pjësërisht (harresë e orëve shtesë të bëra për shembull. Mashtrimet dhe zhgënjimet janë të shumta.
- Unë nuk kam asjnë lloj të drejte në çështje me sigurimet shoqërore (pa aftësi për punë, materniteti, invalid, vdekje, pension , dhe papunësi). Në rast aksidenti nuk jam i mbrojtur. Pra asnjë sigurim dhe asnjë ankesë.
- Punëdhënësi mund të kërkojë nga unë ç'farë të dëshirojë : të punoj me një rrogë më të vogël se rroga e ligjshme, të punoj më shumë që zgjatja (e orëve të punës) e ligjshme, të më heqë nga puna kur të dëshirojë....
- Nesë kam një ndihmë të asistencës (chomage-it) ose të CPAS-it mund të jeni i sanksionuar, i përjashtuar ndoshta të jem i detyruar të rimbursoj ndihmat (në të holla) e marra padrejtësisht.
- Denuncimet dhe kontrollet janë të shpeshta dhe si pasojë gjoba dhe sonksionime të tjera.

Inspektimi i ligjeve Shoqërore është kompetent në lidhje me të drejtën në punë. Ajo trajton për shembull: problemet e rrogave, paralajmërimet, zgjatje dhe kohë pune. Ajo mund bëjë kontrolle në vendin e punës, ndoshta fillesën, ndoshta në rastin e një ankese, për të vërtetuar që rregullorja në punë është respektuar.

Në rast problemi, mund të drejtohem falas tek Inspeksioni i L igjeve Shoqërore ose tek Gjykata e punës. Unë mund të marr gjithashtu këshillë pranë sindikatës.

SPF Emploi, Travail et Concertation sociale - Rue Ernest Blerot, 1 - 1070 Bruxelles – 02 233 41 11 – information@emploi.belgique.be